



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:240792

Datë: 18.06.2024

Numri i dokumentit: 05830485

Ac.nr.10672/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Naime Ahmeti, kryetare e kolegjit, Ylber Shurdhiqi dhe Adnan Konushevcu, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses T. SH.A. me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A.G., kundër të paditurit H.B., me vendbanim në Prishtinë, në Lagjen A., rr. “...” pn, për kthimin e borxhit në vlerë prej 3,354.59 €, duke vendosur sipas ankesës të autorizuarës të paditëses, e ushtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2764/2016 të datës 22.09.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 13.06.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet e pathemeltë ankesa e paditëses T. SH.A. me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2764/2016 të datës 22.09.2021, vërtetohet.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.2764/2016 të datës 22.09.2021, në pikën një të dispozitivit ka refuzuar si të pabazuar kërkesë padinë e paditëses T. Sh.A. me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar të detyrohet i padituri H.B. ta përmbush detyrimin ndaj paditëses T. SH.A. në shumën prej 3,354.59 €, si dhe interesin e paraparë me LMD duke filluar nga momenti i rënies në vonesë e deri në ditën e pagesës, si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 40 €, e të gjitha në afat prej 7 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjyqimit e nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm. Në pikën dy të dispozitivit ka vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur e autorizuara e paditëses, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e

Apelit aktgjykimin e atakuar ta prish dhe lëndën t'ia kthej në rigjykim dhe rivendosje gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së neneve 194 dhe 195.1, pika (d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, ka gjetur se:

-Ankesa është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, me padinë e parashtruar në gjykatën e shkallës së parë, me datën 11.11.2016, kundër të paditurit H.B. nga Prishtina ka kërkuar përmbushur e detyrimit i cili rrjedh nga Marrëveshja e Kredit Kartelës në shumë prej 3,354.39 €.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësve, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqës dhe të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar me të cilën e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar për shkak të parashkrimit duke u bazuar në dispozitat e neneve 360, 361, 371 dhe të LMD-së, ndërsa vendimin për shpenzime e ka marrë bazuar në nenin 450 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 181 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar, pasi që pas administrimit të provave që gjenden në shkresa të lëndës ka vërtetuar se: nga raporti i paditëses ka konstatuar se tani i padituri nga momenti i arritjes së marrëveshjes së kredit kartelës kohë pas kohe ka tërhequr mjete monetare nga tani paditësja, e po ashtu edhe ka bërë pagesa të kohëpaskohshme në emër të përmbushjes së borxhit, ndërsa tërheqja e fundit ka qenë me datë 18.10.2011. Paditësja me rastin e paraqitjes së padisë, ka kalkuluar shumën e borxhit përfshirë edhe kamatën e llogaritur edhe pas datës 18.10.2011 kur i padituri ka bërë tërheqjen e fundit të mjeteve e deri me datë 06.06.2012, ashtu që shumën e kalkuluar nga kamata e papaguar ia ka shtuar borxhit të arritur deri me datë 18.10.2011, që ishte 2,854.34, e në shumën e përgjithshme prej 3,354.39 €, ndaj në rastin konkret me të drejtë ka konstatuar se kërkesa për kthimin e borxhit si më lartë është kërkesë edhe e parashkruar, pasi që nga data kur i padituri ka bërë tërheqjen e fundit të mjeteve është e datë 18.10.2011, përkatësisht nga muaji pasues që është data 01.11.2011 e deri me datën e paraqitjes së padisë në gjykatë me datë 10.11.2016, kanë kaluar 5 vjet që është afati i përgjithshëm i parashkrimit. Po ashtu marrë parasysh faktin se marrëveshja e kredit kartelës ka qenë kërkesë periodike dhe se kërkesa e fundit e kamatës ka datuar me datë 06.06.2012, gjykata e shkallës së parë, me të drejtë ka konstatuar se kërkesa e paditëses për kthimin e borxhit dhe kamatës si

kërkesë aksesore, janë parashkruar siç është e përshkruar me dispozitën e nenit 372 të LMD-së (ligji i RSFJ-së, i cili ligj ka qenë në fuqi në kohën e krijimit të raportit juridik), se: *''Kërkesat e dhënieve periodike që rrjedhin vit për vit ose në afate të caktuara më të shkurtëra (kërkesat periodike) si kur është fjala për kërkesat periodike aksesore, sikunder është kërkesa e kamatës, ashtu edhe kur është fjala për kërkesën periodike të atilla në të cilat sositet vetëm e drejta sikundër është kërkesa e ushqimit, parashkruhen tre vjet nga rrjedhja e secilës dhënie të veçantë për pagesë''*. Afati është koha e caktuar me ligj në bazë të cilit mund të kërkohet ndonjë e drejtë dhe se pas kalimit të këtij afati, e drejta e kërkesës nuk mund të realizohet përmes rrugës gjyqësore.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo konsideroi se të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Më tutje, gjykata e shkallës së dytë e ka vërtetuar edhe vendimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur shpenzimet procedurale, duke qenë se gjykata e shkallës së parë, me të drejtë është bazuar në nenin 450 të LPK-së.

Nga të gjitha arsyet e cekura në arsyetim të këtij aktgjykimi të shkallës së dytë, Gjykatës së Apelit i rezulton se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga nenet 194, 195, paragrafi 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.10672/2021, me datë 13.06.2024

Kryetare e kolegjit  
Naime Ahmeti, d.v.